



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETAR

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, për: *Një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për "Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore", i ndryshuar.*

Me respekt,


K R Y E T A R I

Ilir XHAKOLLI

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2025

PROJEKT – VENDIM
NR. ____, DATË ____ . ____ .2025
PËR


**NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 105, DATË 02.12.2021
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE
PUBLIKE” DHE “HARTA QË PËRCAKTON RRUGËT E QYTETIT, TË CILAT
PËRJASHTOHEN NGA KJO RREGULLORE”, I NDRYSHUAR.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 64, shkronjës “c” të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 4/1 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17 të VKM-së nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë në nenin 7 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për “Miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, i ndryshuar”, shtimin e shkronjës f) *Nuk lejohet tregëtimi i produkteve të ndryshme të përdorura (si veshje, këpucë, aksesore, lodra etje) në ambientet e hapura, qofshin këto publike dhe jopublike.*”
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

K R Y E T A R E
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
D.P.K.ZH.T

Nr. ____ prot.

Pogradec, më _____._____.2025

RELACION

Në lidhje me Projekt -Vendimin për "Një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 105, datë 02.12.2021 për "Miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore", i ndryshuar.

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë !

Duke parë që në hapësirat publike dhe jopublike, subjekte dhe individë ushtrojnë veprimtari "Shitje artikuj të përdorur, si veshje, këpucë, aksesorë, lodra" në ambjentet e hapura, në mungesë totale të kushteve higjeno- sanitare, të cilat mund të bëhen shkak ndotjeje dhe epidemi të ndryshme për qytetarët, shqetësim për banorët e pallatit para të cilit kryhet ky aktivitet, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Treritorit vendosi t'i propozojë Këshillit Bashkiak *të mos lejohet tregëtimi i produkteve të ndryshme të përdorura (si veshje, këpucë, aksesorë, lodra, etje) në ambjentet e hapura, qofshin këto publike dhe jopublike, në Rregulloren "Për shfrytëzimin e hapësirave publike" dhe "Harta që përcakton rrugët e qytetit ,të cilat përjashtohen nga kjo rregullore", i ndryshuar",*

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në ligjin 197/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre

publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji u ka njohur ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Proçedurës Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit 44/2015 “Kodi i Proçedurës Administrative”, pasi është një akt nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk është i shteruar në zbatimin e tij dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec dhe kundrejt një numri të pacaktuar subjektsh. Gjatë zbatimit të tij, ky projekt-vendim shtrin efektet në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec dhe kundrejt një numri të pacaktuar subjektsh.

Përfundimish konkludojmë se akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim!

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Marjano Tasellari

Miratoi: Paskalino Ziko

Konfirmoi: Dritan Babasuli

Përcaktoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik:

Jurist i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit: Taulant Fejzo

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

